

VENDIM
Nr.546, datë 9.8.2006

**PËR NJË SHITESË FONDI, NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE, PËR
KRYERJEN, JASHTË VENDIT, TË TRANSPLANTIT TË VESHKËS, PËR DISA
SHTETAS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, zëri “Shpenzime për mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi prej 18 500 000 (tetëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve, për kryerjen jashtë vendit, të transplantit të veshkës, për disa shtetas.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha